



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 329/5 Prot.

Tiranë, më 30.05. 2016

V E N D I M
Nr. 62, datë 30.05.2016

***"Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 329/1 prot, datë 05.05.2016"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 329/1 prot, datë 05.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 956/2 prot., datë 04.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike "Për lirimin nga një pozicion i rregullt i anëtarit të TND-së", në lidhje me lirimin e nëpunëses ***** nga pozicioni "Drejtor i Përgjithshëm", pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 329/2, datë 05.05.2016, "Njoftim mbi fillimin e verifikimit", u vu në dijeni Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, dhe iu kërkua dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e këtij procesi.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 2148/1, datë 18.05.2016, drejtuar Komisionerit, ka sqaruar se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e padisë së ngritur prej nëpunëses ***** , ka filluar shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore në datën 19.05.2016 (gjë e cila vërtetohet edhe me kopjen e fletë-thirrjes, me nr. 3555, datë 27.04.2016), me objekt të njëjtë me atë të urdhrit për fillimin e verifikimit të ligjshmërisë të këtij rasti, nxjerrë nga ana e Komisionerit.

Duke qenë përpara këtij fakti, Departamenti i Administratës Publike në të njëjtën shkresë, ka kërkuar të pushohet procedimi administrativ nga ana e Komisionerit, me arsyetimin se pretendimet e nëpunëses në fjalë do të trajtohen dhe zgjidhen në mënyrë përfundimtare, prej gjykatës kompetente.

Në këto kushte, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116 datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i RSH”, që institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësohet se në këtë rast, nuk është e nevojshme ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 329/1 prot, datë 05.05.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 956/2 prot., datë 04.03.2016, për lirim nga një pozicion i rregullt i anëtarit të TND-së”, që ka të bëjë me lirim nga nëpunëses *****, nga pozicioni “Drejtor i Përgjithshëm”, pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike si dhe kërkuësja, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA